



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Univerziteteska Bolnička i Klinička Služba Kosova (UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)



Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm të SHSKUK-së

Raport i Punës 2018-SHSKUK

Përgatitur nga:

Basri Sejdiu-Drejtore i Përgjithshëm në SHSKUK dhe
Liridon Gashi-Shef i sektorit për monitorim dhe vlersim të cilësisë së punës në SHSKUK

Datë: 24.01.2019

Falënderim:

Zyra e Drejtorit të SHSKUK-së, falënderon të gjithë punëtorët e njësive përbërse të saja, veçanërisht punëtorët mantil bardhë të cilët kanë bërë një punë shumë voluminoze dhe profesionale shëndetësore, si dhe drejtorët e njësive përbërse të SHSKUK-së të cilët kanë qenë të involvuar në punë gjatë gjithë kësaj periudhe.

Misioni:

“Përmirësimi i gjendjes shëndetësore dhe kënaqshmërisë së popullatës nëpërmjet promovimit të mënyrave të shëndetshme të jetesës dhe sigurimit të shërbimeve cilësore shëndetësore me qasje të lehtë, të barabartë, pa rrezik financiar dhe kosto-efektive”.

Përmbajtja

Hyrje.....	7
Fjala Hyrëse e Drejtorit.....	8
1. Shërbimet e përgjithshme në Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK).....	9
2. Shërbimet e ofruara në Qendrën Klinikë Universitare të Kosovës.....	13
3. Shërbimet e Spitaleve të Përgjithshme	15
4. Shërbimet e ofruara nga Qendra Klinike Stomatologjike Universitare e Kosovës	16
5.Shërbimet e ofruara nga Qendrat Profesionale të Shëndetit Mendor të Kosovës.....	17
6. Shërbimet tjera të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës.....	18
6.1. Qendra Kombëtare e Mjeksisë së Punës.....	18
6.2. Qendra Kombëtare e Telemjeksisë të Kosovës.....	19
6.3. Qendra Kombëtare Mjeksisë Sportive të Kosovës.....	20
7.Shërbimet tjera specifike të ofruara në SHSKUK.....	21
7.1. Klinika e Kardiokirurgjisë në QKUK.....	21
7.2. Shërbimet Radiologjike në SHSKUK.....	22
7.3. Shërbimet e Dializës në SHSKUK.....	23
7.4. Lindjet në SHSKUK.....	23
7.5. Shërbimet e Klinikës së Onkologjisë në QKUK.....	24
8. Shërbimet Farmaceutike në SHSKUK.....	26

Lista e Shkurtesave

SHSKUK	Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës
MSH	Ministria e Shëndetësisë
BD	Bordi Drejtues
MF	Ministria e Financave
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
QKUSK	Qendra Klinike Universitare Stomatologjike e Kosovës
QKMP	Qendra Kombëtare e Mjekësisë Sportive
QKMS	Qendra Kombëtare e Mjekësisë Sportive
QKTGJ	Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut
QKT	Qendra Kombëtare e Telemjekësisë
SP	Spitali i Përgjithshëm
QSHMK	Qendrat e Shëndetit Mendor me Shtëpitë për Integrim në Bashkësi
QIRSK	Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronik Psikiatrik
BQ	Barnatorja Qëndrore

Hyrje :

Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK) është institucion unik, i formuar sipas Ligjit për Shëndetësi nga Qeveria e Republikës së Kosovës, përderisa Statuti i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës është miratuar në mbledhjen e 148 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me vendim nr. 05/148, datë 11.09.2013. Formimi i SHSKUK është e saktësuar në nenin 62 të Ligjit për Shëndetësi. Në paragrafin e parë të këtij neni, theksohet se Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës themelohet si institucion autonom dhe i pavarur publik shëndetësor, me rëndësi të veçantë publike, me seli në Prishtinë. SHSKUK përbëhet nga institucionet e nivelit dytësor dhe tretësor të kujdesit shëndetësor në sektorin publik të shëndetësisë. Institucionet shëndetësore të nivelit dytësor dhe tretësor të kujdesit shëndetësor, të cilat përbëjnë SHSKUK-në, janë si vijon:

- 1.1. Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK);
- 1.2. Qendra Klinike Universitare Stomatologjike e Kosovës;
- 1.3. Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës në Gjakovë;
- 1.4. Qendra Kombëtare e Mjekësisë Sportive
- 1.5. Qendra Kombëtare e Telemjekësisë;
- 1.6. Spitali i Përgjithshëm në Mitrovicë;
- 1.7. Spitali i Përgjithshëm në Gjilan;
- 1.8. Spitali i Përgjithshëm në Pejë;
- 1.9. Spitali i Përgjithshëm në Gjakovë;
- 1.10. Spitali i Përgjithshëm në Prizren;
- 1.11. Spitali i Përgjithshëm në Ferizaj;
- 1.12. Spitali i Përgjithshëm në Vushtri;
- 1.13. Qendrat e Shëndetit Mendor me Shtëpitë për Integrim në Bashkësi;(Prishtinë, Mitrovicë, Gjilan, Prizren, Pejë, Gjakovë dhe Gjilan;
- 1.14. Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronik Psikiatrik në Shtime.



Fjala hyrëse e Drejtorit të Përgjithshëm

Përkundër sfidave dhe vështirësive me të cilat u ballafaquam në periudhën e vitit 2018, Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës përmbylli sukseshëm këtë periudhë të vitit me një punë voluminoze si në aspektin profesional shëndetësor dhe atë administrativ. Në fillim të vitit është bërë riorganizim i mbrendshëm me strukturë të re organizative në SHSKUK i cili mundëson fuqizimin dhe vazhdimin e reformës në sistemin shëndetësor. Është bërë planifikim i mirëfillët i kërkesave për pajisje mjekësore për njësitë përbërëse të SHSKUK-së, pajisje të cilat janë siguruar pas shumë viteve mungesë, si dhe janë nënshkruar kontrata për aparaturë moderne dhe të domosdoshme për punë të cilat do të përmirsojnë dukshëm kualitetin e shërbimeve shëndetësore në SHSKUK/QKUK.

Për të përmirësuar kujdesin shëndetësor janë marrë vendime shumë domethënëse, që ngashtimi i shërbimeve në 24h në klinikën e Kardiologjisë Invazive dhe Kardiokirurgjisë dhe Klinikën e Onkologjisë, përmirsimi i kushteve të punës në Klinikën ekzistente Emergjente dhe funksionalizimi i Shërbimit të Klinikës së Anestezionit dhe Mjekimit Intenziv si dhe Ambulancat Specialistike me Administratë Qendrore.

Për-kundër kushteve të punës, njësitë përbërëse të SHSKUK-së realizuan numër të konsiderueshëm të shërbimeve shëndetësore, përfshirë operacione, shërbime diagnostike dhe vizita ambulatore.

Në SHSKUK në periudhën e vitit 2018, u ofruan 7.4 milion shërbime, 846828 të shërbimeve ishin ditë shërimi në nivel të Kosovës me 163013 pacientë të shtrirë. 41091 operime janë kryer në nivel të SHSKUK-së. Shërbime ambulatore ishin 1508725 shërbime. Ndërsa shërbime (parametra) laboratorike janë 2930787 për 511830 pacientë. Lindje gjithsej ishin 22091, Numri i shërbimeve të dializës arrinë numrin e 124446 ndërsa shfrytëzimi i kapaciteteve është 59.37 %.

Përqëndrimi kryesor ishte në mbarëvajtjen e shërbimeve të domosdoshme për ofrim të shërbimeve shëndetësore, sidomos në shërbimet Emergjente të Kardiologjisë Invazive me Kardiokirurgji ku gjatë kësaj periudhe janë realizuar 1663 stentime dhe 2517 Koronarografi dhe 212 operime.

Furnizimi me produkte mjekësore nga Lista Esenciale në QKUK është me barëra ishte 63%, 51% me material hargjues dhe 57% me citostatik. Spitalet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës arrijnë një mesatare të furnizimit me 62.32% në Barëra dhe 48.78 % në Material shpenzues. Barnatoret në SHSKUK kanë pranuar donacione në vlerë 4.1 milion euro.

Detajet tjera rreth punës në secilën nga njësitë përbërëse të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar i gjeni në raportin e detajuar.

Basri Sejdiu


Drejtor i Përgjithshëm

Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës


1.Shërbimet e përgjithshme në Shërbimin Spitalor Klinik Universitar te Kosovës

Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës në sistemin e pagave ka të regjistruar 7076 punëtorë. Mjekë specialistë janë 22% e stafit, infermier/e janë 60% dhe 18% e stafit është staf jo- mjekësor.

Të shprehur në numra, 1562 janë mjekë specialistë, 4239 të punëtorëve janë infermier/e dhe 1275 janë kuadër tjetër jomjekësor.



Figurë : Struktura kualifikuese SHSKUK



Struktura gjinore në SHSKUK

Femra	Meshkuj	Totali
4599	2477	7076

Figure : Struktura Gjinore në SHSKUK

Figura, tregon qe 35% janë meshkuj të punësuar dhe 65% e te punësuarve janë femra.

Aktivitetet e punës në Shërbimin Spitalor Klinik Universtar të Kosovës:

Total Shërbimet SHSKUK												
Njësia	Klinika/Spitalet	Nr i shtretërve	Ditë shërimi	Nr. të shtrirëve	Nr. të operuarve	Vizita ambulatore/qendri me ditore SHM	Shërbime laboratorike	Shërbime tjera/apo të veçanta (diagnostike)	Nr i lindjeve	Nr i dializave	Mesatarja ditore e shëritimit	Shfrytëzimi i kapaciteteve
QKUK	37	1908	465488	78791	22715	517880	1246917	903413	9963	39374	5.91	66.84
Spitalet	7	2000	381340	84222	18376	825381	1571406	549889	12128	85072	4.53	52.24
Shëndeti Mendor	8	154				64027		288353				
Mjekësia e Punës	1					28361	112464	48345				
QSKUK	1					51829		278693				
QKMS	1					21247						
Telemjekësia	1							34641				
Totali	56	4062	846828	163013	41091	1508725	2930787	2103334	22091	124446	5.19	59.37

Tabela : Total Shërbimet SHSKUK

Në SHSKUK në periudhën e vitit 2018, u ofruan 7.4 milion shërbime, 846828 të shërbimeve ishin ditë shërimi në nivel të Kosovës me 163013 pacientë të shtrirë. 41091 operime janë kryer në nivel të SHSKUK-së. Shërbime ambulatore ishin 1 508 725 shërbime. Ndërsa shërbime (parametra) laboratorike janë 2 930 787 për 511 830 pacientë.


Gjatë kësaj periudhe pune, në Qendrën Klinike Universitare kanë qenë 465 488 ditë shërimi, me 78791 pacientë të shtrirë, nga këta pacientë të shtrirë 22715 pacientë janë operuar. Gjatë kësaj periudhe janë ofruar 517880 shërbime ambulatore për pacientë dhe 903413 ishin shërbime të veçanta dhe diagnostike, ndërsa shërbime (parametra) laboratorike janë kryer 1246917 për 343085 pacient.

Në 7 Spitalet e Përgjithshme kishte 381 340 ditë shërimi, me 84 222 pacientë të shtrirë, nga këta pacient 18376 janë operuar. Gjithsej vizita ambulatore janë ofruar 825381, ndërsa shërbime (parametra) laboratorike ishin 1571406 për 159933 pacientë, shërbime tjera apo të veçanta dhe diagnostike janë ofruar 549889 shërbime.

QKSUK-ja, gjithsej ka kryer 51829 vizita të para dhe vizita kontrolluese. Shërbime tjera të veçanta në QSKUK si shërbimet specifike të tyre janë kryer 278693.

Në Qendrat Profesionale të Shëndeti Mendor me 8 njësi në të gjithë Kosovën kishte 288353 vizita për terapi okupuese dhe shërbime tjera, ndërsa 64027 ishin vizita ambulatorë.

Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës në Gjakovë për këtë periudhë pune, regjistron 28361 vizita ambulatore, me 112464 (parametra) shërbime laboratorike për 8812 pacientë dhe 48345 shërbime të veçanta. QKMS-ja, ka kryer 21247 shërbime specialistike dhe QKT (telemjekësia) ka kryer 34641 shërbime.



Figurë : Totali i shërbimeve SHSKUK

Gjatë kësaj periudhe, nga të gjitha shërbimet mjekësore në SHSKUK, 1% janë operime, 20% nga shërbimet janë shërbime ambulanotre, 40% e parametra laboratorike, 28% nga total shërbimet mjekësore janë shërbime tjera sipas specifikave dhe shërbime diagnostike apo të veçanta dhe 11% janë ditë shërimi.

	Ditë shërimi	Nr. të shtrirëve	Shfrytëzimi i kapaciteteve	Gjatësia e Shërimit	Numri i Shtretërve
QKUK	465488	78791	66.84	5.91	1908
Spitalet	381340	84222	52.24	4.53	2000
Gjithsej	846828	163013	59.37	5.19	3908

Tabela : Krahasimi i shërbimeve të njëjësive përbërëse të SHSKUK-së.

Gjatësia mesatare shërimit në vitin 2018 në SHSKUK është 5.19 ditë për pacientë të shtrirë. Në QKUK 5.91 ditë shërimi mesatar për pacientë, ndërsa në Spitalet e Përgjithshme 4.53 ditë shërimi për pacientë. Shfrytëzimi i kapaciteteve në SHSKUK është 59.37%. QKUK ka shfrytëzueshmërinë e kapaciteteve me 66.84%, ndërsa spitalet e përgjithshme kanë shfrytëzueshmërinë me 52.24%.

Shërbimet laboratorike			
Emri i Institucionit	Nr i Pacientëve	Analizat e Realizuara	% e analizave te realizuar
Spitali Vushtrri	5613	42411	1%
Spitali Gjakovë	26801	134005	5%
Spitali Mitrovicë	18121	61695	2%
Spitali Ferizaj	19310	82283	3%
Spitali Gjilan	24911	198416	7%
Spitali Prizren	45075	650244	22%
Spitali Pejë	20102	402352	14%
QKUK	343085	1246917	43%
Mjekësia e Punës Gjakovë	8812	112464	4%
Totali	511830	2930787	


Tabela : Shërbimet laboratorike të njërive përbërse të SHSKUK-së

Shërbime apo parametra laboratorike në nivel të SHSKUK-së janë kryer 2 930 787 për 511830 pacient. QKUK ka kryer 43% të shërbimeve ndërsa Spitali i Prizrenit ka kryer 22% të shërbimeve laboratorike në nivel të SHSKUK-së.

2.Shërbimet e ofruara në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës- QKUK

Në QKUK, 37 klinika, institute dhe shërbime ofrojnë shërbime shëndetësore të ndryshme varësisht nga specifikat e tyre.

QKUK në listën e pagave ka gjithsej 3243 punëtorë, 1981 punëtor i përkasin sektorit infermirisë, 768 punëtorë i përkasin sektorit të mjekëve specialistë dhe 535 punëtorë i përkasin stafit jo- mjekësor.



Figurë : Struktura kualifikuese QKUK

Shërbimet shëndetësore të ofruara gjatë kësaj periudhe do të pasqyrohen si në tabelën në vijim:

Nr	QKUK	Repart i	Nr i Shtretëve	Ditë shërimi	Nr. të shtrirëve	Nr.të operuarve	Vizita ambulante	Vizita tjera diagnostike	Shërbime laboratorike	Shërbime tjera/apote vecante	Shfr i kapaciteteve
1	Klinika Obstetrike Gjinekologjike	13	396	86977	18005	5720	7054	6846		128966	60.2
2	Klinika e Dermatovenerologjisë	3	36	8107	889		17666	1256		2534	61.7
3	Kirurgjia Abdominale	5	68	17179	2985	2351	4648	2023		3800	69.2
4	Klinika e Kirurgjisë Maksillofaciale	1	25	6100	800	1229	9308	4219		9269	66.8
5	Klinika Ortopedisë dhe Traumatologjisë	4	103	16098	2740	2771	27047	3320		12996	42.8
6	Klinika e Kirurgjisë Torakale	1	26	7068	938	844	2847	234		5593	74.5
7	Klinika e Gastroenterologjisë	1	33	9519	958		6424	2843		13532	79.0
8	Klinika e Hematologjisë	1	31	6736	675		6102	1245		6328	59.5
9	Klinika e Neonatologjisë	1	180	39550	10947		24793	3507			60.2
10	Klinika infektive	7	126	31490	3275		19871	11206		3811	68.5
11	Klinika e Syve	1	49	10214	2758	2566	36647	3343		4981	57.1
12	Klinika e Nefrologjisë	1	24	5989	519		3205	2275		46955	68.4
13	Shërbimi i Ortoprotetikës	1					710			787	
14	Klinika e Pulmologjisë	4	68	22694	1647		17829	1361		3770	91.4
15	Klinika e Kardiologjisë	3	56	19275	5020		18198	24224		5747	94.3
16	Klinika e Pediatrisë	9	151	42279	6764		49162	10162		4846	76.7
17	Klinika e Endrokrinologjisë	1	36	9955	749		9474	29260		2348	75.8
18	Klinika e Anesteziologjisë dhe Reanimacionit	3	41	15114	6202		56916			18972	101.0
19	Klinika e ORL-së	5	74	22859	2456	2128	17263	5827		7070	84.6
20	Klinika e Neurologjisë	1	68	19412	1919		12716	6286		2881	78.2

21	Klinika e Biokimisë Mjekësore	1						1246917			
22	Shërbimi Mjekësi Nukleare	1				658	3491		5171		
23	Shërbimi Klinik Emergjent	1	19			41653				0.0	
24	Klinika e Fiziatrisë	1	14	3806	206	5726	1954		161520	74.5	
25	Klinika e Kirurgjisë Plastike	1	22	3925	658	951	8814		5196	48.9	
26	Klinika e Neurokirurgjisë	1	22	6507	851	518	5622	1722	3364	81.0	
27	Klinika e Urologjisë	1	24	6759	1389	1092	6679	2589		15.9	
28	Klinika e Onkologjisë	1	10	1425	196		62572		72035	39.0	
29	Klinika e Kardiokirurgjisë dhe Kardiologji Invazive	1	15	2863	274	212	610	2517	1663	52.3	
30	Klinika e Psikiatrisë	4	68	14046	721		13204	2067	3317	56.6	
31	Klinika e Radiologjisë	1						196016			
32	Klinika e Reumatologjisë	1	26	8226	1195		6288	830	482	86.7	
33	Klinika e Kirurgjisë së Fëmijëve	1	37	5260	1786	1353	5245	29	2644	38.9	
34	Klinika Kirurgji Vaskulare	1	24	7033	1239	980	8405		6642	80.3	
35	Alergologjia	1					2988	2652	462		
36	Instituti i Psikiatrisë Forenzike	3	36	9023	30		346	304	211	68.7	
37	Institutet Paraklinike	1					1190	18769	3143		
	Total	88	1908	465488	78791	22715	517880	352377	1246917	551036	66.8


Tabela : Totali Shërbimet e QKUK-se

Në Qendrën Klinike Universitare kanë qenë 465488 ditë shërimi, me 78791 pacientë të shtrirë, nga këta pacientë të shtrirë 22715 pacientë janë operuar. Gjatë kësaj periudhe janë ofruar 517880 shërbime ambulantore për pacientë dhe 352377 ishin shërbime të veçanta dhe diagnostike, ndërsa shërbime (parametra) laboratorike janë kryer 1 246 917 për 343085 pacient, shërbime tjera të vecanta ishin 551036 shërbime, dhe shfrytëzimi i kapaciteteve në përgjithësi nga klinikat e QKUK-së është 66.8%.

3. Shërbimet e Spitaleve të Përgjithshme

7 Spitalet e Përgjithshme në kuadër të SHSKUK-së operojnë në rajone të ndryshme të Kosovës.

Spitalet e Përgjithshme në kuadër të SHSKUK-së kanë gjithsej 3243 punëtorë. 636 punëtorë janë të kuadrit jo- mjekësor, 1946 janë të kuadrit infermierisë si dhe 661 punëtorë janë mjekë specialistë.




Figurë :Struktura kualifikuese –Spitalet e Përgjithshme

Shërbimet e Spitaleve të Përgjithshme të Kosovës do të pasqyrohen në tabelën në vijim:

Shërbimet e Spitaleve të Përgjithshme SHSKUK									
Spitalet në Kosovë	Nr i Shtre terve	Ditë sherimi	Nr i të shtrirëve	Nr i të Operuarve	Vizita Ambulatore	Shërbime Laboratorike	Shërbime Tjera/ Diagnostike	Shfrytë e Kapaciteteve	
Spitali Vushtrri	57	16254	4506	1850	44486	42411	21278	78.13	
Spitali Gjakovë	426	72193	15559	2295	83940	134005	16670	46.43	
Spitali Mitrovicë	158	30846	9194	2117	135487	61695	25593	53.49	
Spitali Ferizaj	80	12763	3345	1372	26718	82283	15311	43.71	
Spitali Gjilan	374	63375	12781	1928	190295	198416	46434	46.43	
Spitali Prizren	509	112015	23953	5724	138854	650244	305338	60.29	
Spitali Pejë	396	73894	14884	3090	205601	402352	119265	51.12	
Totali I Spitaleve	2000	381340	84222	18376	825381	1571406	549889	52.24	

Tabela : Shërbimet e Spitaleve të përgjithshme

Tabela e më sipërme tregon që janë gjithsej 381340 ditë shërimi apo 11% të shërbimeve në Spitalet e Përgjithshme për 84222 pacientë të shtrirë në Spitalet e Përgjithshme. Nga këta pacientë, 18376 pacientë janë operuar në të gjitha spitalet të Kosovës. Gjithsej 825381 vizita ambulatore apo 25% e shërbimeve, ndërsa 1571406 shërbime (parametra) laboratorike apo 47% (për 159933 pacient) të total shërbimeve mjekësore. Shërbime tjera specifike dhe diagnostike ishin 549889 apo 16%.




4. Shërbimet e ofruara nga Qendra Klinike Stomatologjike Universitare të Kosovës (QKSUK)

Qendra Klinike Stomatologjike Universitare e Kosovës përbëhet nga gjithsej 177 punëtorë. 20 nga punëtorët janë kuadër jo mjekësor, 78 janë të kuadrit infermierisë si dhe 79 punëtor janë mjekë specialistë.

Në këtë institucion shëndetësor kryhen shërbime stomatologjike, të cilat do të pasqyrohen në tabelën në vijim.


Figure : Struktura kualifikuese QKSUK



QKSUK				
Reparti	Vizita e pare/Vizite Kontrolluese	Aktivitete (sherbime) te Ofruara	Aktivitete jashte Prishtines	Paciente neper klinika
2018	51829	179077	81757	17859

Tabelë 8: Shërbimet e ofruara QKSUK dhe krahasimet

Në QKSUK-ja ka kryer 51829 shërbime si vizita kontrolluese dhe vizita të para, apo me 16% të pjesëmarrjes në total shërbimet e ofruara. 145121 ishin shërbime stomatologjike të ofuara, apo të shprehur në përqindje me 56% të total shërbimeve. Aktivitete jashtë Prishtinës janë kryer 56599, apo me 22%. Shërbime tjera në klinikë janë kryer 14314 apo 6% të shërbimeve.




Figurë : Shërbimet e ofruara QKSUK

5. Shërbimet e ofruara nga Qendrat Profesionale të Shëndeti Mendor


Qendrat Profesionale të Shëndetit Mendor të Kosovës që operojnë në Republikën e Kosovës të cilat janë nën varësi të SHSKUK-së.

Në tetë njësi të shpërndara këto institucionet kanë të punësuar gjithsej 248 punëtor. 36 nga këta punëtorë janë kuadër jo mjekësor, 186 janë infermier/e dhe 26 mjekë specialistë në të gjithë Qendrat e Shëndetit Mendor të Kosovës.

Figurë : Struktura kualifikuese QSHM



Total shërbimet e ofruara nga këto njësi përbërse të SHSKUK-së, do pasqyrohen në figurën si në vijim:




Në Qendrat Profesionale të Shëndeti Mendor me 8 njësi në të gjithë Kosovën ka kryer 7311 vizita shtëpiake, 24944 qëndrime ditore, 31772 vizita specialistike dhe 288353 vizita për terapi okupuese dhe shërbime tjera.

6. Programet tjera të Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës.

Në kuadër të Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës bëjnë pjesë edhe këto institucione shëndetësore:

- Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës në Gjakovë
- Qendra Kombëtare e Telemjekësisë
- Qendra Kombëtare e Mjekësisë Sportive

Gjithsej të punësuar në këto njësi përbërse të SHSKUK-së, janë 124 punëtorë. 48 punëtorë janë të kuadrit jo- mjekësor, 48 janë infermier/e dhe 28 mjekë specialistë.



Figurë : Struktura kualifikuese e programeve tjera të SHSKUK-së

6.1. Shërbimet e ofruara nga Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës

Shërbimet e Qendrës Kombëtare të mjekësisë së punës Gjakovë				
Repartit	Vizita Ambulatore	Vizita Diagnostike	Sherbime Laboratorike	Sherbime Tjera
12	28361	44816	112464	3529

Tabela : Raporti i punës - Mjekësia e Punës Gjakovë

Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës në Gjakovë gjatë kësaj periudhe pune, ka ofruar gjithsej 23361 vizita ambulatorie, apo 15% të total shërbimeve të Mjekësisë së Punës. Janë ofruar 112464 apo 60% të shërbimeve (parametra) laboratorike për 8812 pacientë.

Vizita/shërbime diagnostike gjatë kësaj periudhe ishin 44816 apo 23% e shërbimeve.




Figure : Raport i Punës - Mjekësia e Punës Gjakovë

6.2. Qendra e Telemjekësisë së Kosovës

Tabela e radhës do pasqyrojë vizitat që janë bërë në Qendrën e Telemjeksisë së Kosovës:




Figure : Numri i vizitave ne QTK

Gjatë kësaj periudhe pune në Qendrën Kombëtare të telemjeksisë së Kosovës ishin 15605 vizita në bibliotekën elektronike. Vizitorët më të shpeshtë ishin Studentët që vizituan bibliotekën elektronike të cilët vizituan 11132 herë, mjekët specialist me 4450 vizita, dhe 23vizitor të tjerë.

6.3. Qendra Kombëtare e Mjeksisë Sportive

Qendra Kombëtare e Mjeksisë Sportive e cila është pjesë përbërëse e Shërbimit Spitalor Klink Universitar të Kosovës, kryen këto lloj shërbimesh:

- Vizita specialistike.
- Terapi fizikale.
- Vizita sistematike për sportistë.

Shërbimet e kryera nga QKMS, pasqyrohen në tabelat në vijim:

Kontrollat mjekësore sistematike për sportist		
Kategoritë	Nr. i sportistave	%
FUTBOLL	17133	86%
Volejbol	87	0%
Autoklubet	23	0%
KARATE	104	1%
BOX	63	0%
HENDBOLL	1034	5%
TENIS	6	0%
XHUDO	8	0%
Studenta	451	2%
Individual	92	0%
Refer	564	3%
Gjimnastike	5	0%
Atletike	30	0%
Not	30	0%
Taekëando	33	0%
Basketboll	173	1%
Totali	19836	

Mjekësia Sportive	
Vizita specialistike	407
Terapi Fizikale	1004
Total	1411


Tabela : Kontrolle mjekësore sistematike për sportistë

QKMS, ka kryer 407 vizita specialistike si dhe 1004 terapi fizikale gjatë kësaj periudhe punetë vitit. Në këtë periudhë kjo njësi ka kryer 19836 vizita sistematike për sportistë, 86% e sportistëve apo 17133 janë të kategorisë sportive futbollist, 5% apo 1034 të vizitave sistematike janë të kategorisë hendboll.

7. Shërbime tjera te ofruara në SHSKUK

7.1. Klinika e Kardiokirurgjisë dhe Kardiologjisë Invazive-QKUK

Kardiokirurgji dhe Kardiologji Invazive QKUK



Gjatë kësaj periudhe pune në klinikën e Kardiokirurgjisë dhe Kardiologjisë Invazivë QKUK janë kryer 212 operime. 142 operime By Pass, 35 operime Valvule dhe 35 operime të ndryshme Kardiokirurgjike. Ndërsa në pjesën e Kardiologjisë Invazive në QKUK janë realizuar 1663 Stenta dhe 2517 Kooronarografi.

7.2. Statistika-Shërbimet Radiologjike SHSKUK

Në nivel vendi, janë realizuar gjithsej 44209 CT, 79866 ultrazë, 209508 radiografi, 5826MRI dhe 16548 Mamografi.

	Ct	MRI	Ultrazë	Radiografi	Angjiografi	Mamografi	Shërbime tjera Radiologjike
Spitali Vushtrri	461		1851	2514			
Spitali Gjakovë	2177		12339	16164			866
Spitali Mitrovicë	1066		2002	1647			26
Spitali Ferizaj			3396	7607			
Spitali Gjilan	1755		2159	13727			
Spitali Prizren	4395		7175	24185			
Spitali Pejë	4472		23252	25801			
QKUK	29883	5826	27692	115108	597	16548	362
QKMP				2755			399
Gjithsej	44209	5826	79866	209508	597	16548	1653

Tabela : Shërbimet Radiologjike SHSKUK-

Spitalet e Përgjithshme kanë kryer një numër te konsiderueshme të shërbimeve radiologjike, Spitali i Pejës ka kryer 4472 CT, 23252 ultrazë, 25801 radiografi.

Nga raporti i punës së Klinikës së Radiologjisë QKUK, rezulton se janë kryer radiografi, shërbimet me ultrazë gjithsej 27692. Janë kryer 29883 tomografi të kompjuterizuara (CT) dhe 5826 Rezonanca Magnetike(MRI) dhe 16548 mamografi.

7.3. Realizimi i Dializave SHSKUK

Dializa

Institucioni	Numri i dializave	%
Spitali Vushtrri		0%
Spitali Gjakovë	10901	9%
Spitali Mitrovicë	9058	7%
Spitali Ferizaj	11091	9%
Spitali Gjilan	8882	7%
Spitali Prizren	30150	24%
Spitali Pejë	14990	12%
QKUK	39374	32%
Gjithsej	124446	

Tabela : Numri i dializave SHSKUK -

Gjatë kësaj periudhe pune të punës në SHSKUK, janë realizuar gjithsej 124446 shërbime të dializës. Gjatë kësaj periudhe në QKUK janë kryer 393374 dializa apo 32% e gjithsej dializave. Spitali i Prizrenit ka realizuar 30150 dializa apo 24% e totalit.

7.4. Lindjet në SHSKUK


Gjinekologjia			
Institucioni	Numri i lindjeve	Numri i lindjeve me operim	Numri i fëmijëve të lindur
Spitali Vushtrri	420	145	421
Spitali Gjakovë	1963	610	1984
Spitali Mitrovicë	1439	417	1447
Spitali Ferizaj	1296	208	1509
Spitali Gjilan	1711	436	1715
Spitali Prizren	3380	992	3422
Spitali Pejë	1919	699	1937
QKUK	9963	3128	10225
Gjithsej	22091	6635	22660

Tabela : Numri i lindjeve SHSKUK

Total numri i lindjeve në këtë periudhë është 22091, nga këto lindje 6635 lindje janë kryer me operim, ndërsa numri i fëmijëve të lindur është 22660. Të shprehur në përqindje 77% e rasteve lindjet janë kryer pa operim ndërsa 23% e rasteve janë kryer me operim.


7.5. Shërbimet e Klinikës së Onkologjisë QKUK

Kjo klinikë gjatë kësaj periudhe ka ofruar shërbime për të gjithë pacientët e Kosovës (përfshirë minoritetet) dhe për pacientët jashtë Kosovës sic janë:




- Presheva, Bujanovci dhe Medvegja: pacientëve nga këto regjione ju janë ofruar të gjitha shërbimet (kimioterapi, radioterapi, transfuzion, mjekim ditor suportiv dhe mjekim paliativ ditor)
- Shqipëria: Bashkëpunim shumë të mirë kemi pasë edhe me Klinikën e Neurokirurgjisë Tiranë ku pacientëve nga Shqipëria ju kemi ofruar ndihmë me citostatikë për disa sëmundje malinje të trurit dhe melanomen malinje (ju është dhënë citostatiku Temozolomide). Poashtu për disa raste nga pjesa veriore e Shqipërisë është ofruar shërbimi i radioterapisë.

Shërbim shumë me rëndësi i ofruar nga kjo klinikë është edhe torakocenteza dhe paracenteza (heqja e ujit nga mushkëritë dhe barku).



Sëmundjet malinje rastet e reja janë paraqitur në figurën e mësipërme , më së shumti raste janë paraqitur në pjesën Urogjenital/Gjinekologjik me 376 raste të reja, 340 raste janë paraqitur në Gji, në Kokë-Qafë me 249 raste, 312 Gastrointestinal dhe 206 raste në Mushkëri. Gjithsej 1483 raste të reja gjatë kësaj periudhe të punës.

Incidenca e sëmundjeve malinje-rastet e reja



8. Barnatorja Qëndrore SHSKUK

Figurat në vijim do të tregojnë përqindjen e furnizimit me barna, material medicinal dhe citostatikë të Listës Esenciale në QKUK si dhe njësitet tjera përbërse të SHSKUK-së.




Figure : Përqindja e furnizimit të Barnatores Qëndrore të SHSKUK-së.

Si shihet edhe në figurën e më sipërme, furnizimi me produkte medicinale gjatë kësaj periudhe pune të punës në QKUK, furnizimin me barëra e kemi 63% të furnizimit, në furnizim me material medicinal 51% dhe Citostatikët nga LE 57% të furnizimit për QKUK-në.

Vlera monetare e Donacioneve të pranuar në Barnatoren Qendrore të SHSKUK/QKUK-së dhe barnatoret e Spitaleve të Përgjithshme gjatë kësaj periudhe, arrin shumën e **4.1 milion euro** për barëra dhe material medicinal shpenzues.




Tabela :Përqindjet e furnizimit nga Lista Esenciale për Barna dhe Materdial medicinal nga Spitalet e Përgjithsme

Ndërsa në Spitalet e Përgjithshme kemi një mesatare të furnizimit me barëra nga Lista Esenciale (LE) 62% dhe Material medicinal nga LE 49%.